

Ligjëratë nga lënda:

Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne

Përmbledhje ligjërate VI

Forca ushtarake

- SHBA-të kanë rreth 20 mijë punonjës diplomatik, por ushtarë kanë 2 milion; ajo shpenzon afërsisht 10 miliardë dollarë në vit për ndihmën e huaj, por më shumë se 250 miliardë dollarë për forcat ushtarake.
- Forcat ushtarake u japin shteteve mjete të tjera ndikimi, të cilat ekzistojnë veçmas mjeteve të larmishme joushtarake të ndikimit që përdoren gjerësisht në përpjekjet ndërkombëtare për marrëveshje.
- Udhëheqësit politik ndeshen me zgjedhje të vështira për organizimin e forcave ushtarake dhe sigurimin e gjetejen e mjeteve financiare për to.
- Në vitet 1990, forcat dhe shpenzimet ushtarake të fuqive të mëdha, sidomos të Rusisë, u pakësuan e u ristrukturuan.
- Forcat ushtarake përfshijnë një larmi të madhe aftësish të përshtatura për qëllime të ndryshme. Lufta tradicionale kërkon lloje të ndryshme forcash ushtarake në krahasim me ato që nevojiten për të kërcënuar për përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike.
- Perveqse në kohë lufte qytetare, udhëheqësit e shteteve, qofshin këta civil ose ushtarakë, i kontrollojnë forcat ushtarake nëpërmjet një zingjiri të vetëm të komandës hierarkike.
- Forcat ushtarake mund të kërcënojnë pushtetin e brendshëm të udhëheqësve të shtetit, të cilët janë të cenusshëm kundrejt përmbyesjes me grusht shteti.
- Kontrolli mbi territorin është themelor për sovranitetin shtetëror dhe kryhet para së gjithash me forca ushtarake tokësore.
- Raketat e vogla dhe lufta elektronike janë gjithnjë e më shumë të rëndësishme, sidomos për forcat ushtarake detare e ato ajrore. Roli i satelitëve po zgjerohet në komunikim, lundrim dhe vëzhgim.
- Armët e shkatërrimit masiv, dmth ato bërthamore, kimike e biologjike, janë përdorur vetem në pak raste në luftë.
- Prodhimi i armëve bërthamore është teknikisht brenda mundësive të shumë shteteve dhe të disa aktorëve joushtetërorë, por materiali i ndashëm i nevojshëm (uranium 235 ose plutonium) është shumë i vështirë për t'u gjetur.
- Pjesa më e madhe e shteteve të industrializuara dhe shumë shtete të varfëra janë shmangur me vetëdije nga zotërimi i armëve bërthamore. Këto shtete përfshijnë dy fuqi të mëdha, Gjermaninë e Japoninë.
- Shtetet që po posedojnë raketa balistike, të afta për të goditur shtete të tjera prej një largësie prej qindra miljesh larg (ose më larg, në varësi të rrezes së veprimit të raketës), janë më të shumta në numër. Megjithatë, asnjë shtet nuk ka sulmuar ndonjëherë një tjetër me armë të shkatërrimit masiv të montuara në raketa balistike.

- Armët kimike janë më pak të kushtueshme për t'u prodhuar se sa armët bërthamore, kanë vlerë të përafërt kërcënuese dhe prodhimi i tyre është më i vështirë për t'u gjurmuar. Numri i fuqive të mesme që kanë armë kimike është më i madh se sa i atyre që kanë armë bërthamore. Një traktat i ri ndalon zotërimin e përdorimin e armëve kimike.
- Disa shtete bëjnë kërkime për luftën biologjike, por zotërimi i këtyre armëve është i ndaluar me traktat.
- Ngadalsimi i përhapjes së raketave balistike dhe i armëve të shkatërrimit masiv në botën e tretë është një shqetësim kryesor për fuqitë e mëdha.
- SHBA-të dhe Rusia kanë rezerva prej mijëra armësh bërthamore; Kina, Britania dhe Franca kanë qindra të tilla. Vendosja e armëve udhëhiqet nga strategjia bërthamore e mbështetur në konceptin e kërcënimit.
- Marrëveshjet për kontrollin e armëve, zyrtarisht përcaktojnë kornizën e garës së armatimeve ose të procesit të ndërsjelltë të çarmatimit. Kontrolli i armëve ndihmoi për të krijuar besim ndërmjet superfuqive gjatë Luftës së Ftohtë.